



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në pajtim me nenin 47, paragrafi (1), pika 6) dhe nenin 19 paragrafi (2) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/21 dhe 74/24), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

V E N D I M **për kredi brenda ditës**

1. Me këtë kredi rregullohen kushtet dhe rregullat për realizimin e operacioneve kreditore që kryen Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) me banka, filiale të bankave të huaja dhe kursimore (në tekstin e mëtejshëm: pjesëmarrësi/pjesëmarrësit) nëpërmjet miratimit të kredisë brenda ditës.

2. Kërkesë për kredi brenda ditës mund të paraqesin pjesëmarrësit që i plotësojnë kriteret në vijim:

- kanë obligim të rezervës së detyrueshme te Banka Popullore,
- pjesëmarrës në Sistemin Pagesor Ndërbankar Maqedonas (në tekstin e mëtejshëm: MIPS);
- të kenë qasje te sistemi elektronik i Bankës Popullore (në tekstin e mëtejshëm: sistem elektronik) dhe
- Të kenë lidhur Marrëveshje gjenerale repo me Bankën Popullore.

3. Banka Popullore miraton kredi brenda ditës për pjesëmarrësit duke realizuar një transaksion repo me datë maturimi gjatë të njëjtës ditë.

Për kredinë e miratuar brenda ditës Banka Popullore nuk llogaritë dhe ngarkon interes.

4. Sikur instrumente për sigurim të kredisë brenda ditës përdoren letrat me vlerë të shënuara në listën e letrave me vlerë për zbatimin e operacioneve monetare, të miratuar në bazë të vendimit për përcaktimin e instrumenteve për sigurim gjatë zbatimit të operacioneve monetare.

5. Kredi brenda ditës miratohet me kërkesë të pjesëmarrësit.

Këshilli Ekzekutiv i Bankës Popullore ka të drejtë të kufizojë miratimin ose të refuzojë kërkesën për kredi brenda ditës nëse pjesëmarrësi nuk i ka përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Bankës Popullore në bazë të një kredie të miratuar më parë dhe të afatizuar.

6. Kërkesa përmban këto elemente:

- shumë monetare të kredisë brenda ditës në denarë, të cilën pjesëmarrësi e kërkon nga Banka Popullore;
- shenja e letrave me vlerë (ISIN – International Securities Identification Number, pra shenjë të ankandit) të cilat pjesëmarrësi i ofron si instrument për sigurim;
- shuma nominale e letrave me vlerë;
- llogaria për shlyerje në MIPS;
- llogari e letrave me vlerë në depozitim të letrave me vlerë.

Pjesëmarrësi e paraqet kërkesën deri te Banka Popullore nëpërmjet sistemit elektronik, gjatë ditës së punës në MIPS, jo më vonë se ora 16 dhe është e parevokueshme.

7. Në rast të problemeve teknike gjatë përdorimit të sistemit elektronik, pjesëmarrësi mund ta paraqesë kërkesën në Bankën Popullore përmes postës elektronike ose bisedës telefonike në lokalin e cila regjistrohet. Banka Popullore e raporton pjesëmarrësin për kredinë e miratuar brenda ditës nëpërmjet postës elektronike, telefonit ose mënyrës tjetër të raportimit.

8. Për kredinë e miratuar brenda ditës përpilohet një konkluzion në përputhje me Marrëveshjen gjenerale repo të lidhur me pjesëmarrësin.

9. Pjesëmarrësi është i detyruar të kthejë kredinë brenda ditës jo më vonë se në momentin kur MIPS-i ndalon marrjen e urdhrave për transferimin e fondeve nga pjesëmarrësit e MIPS-it për përdoruesit e tyre të shërbimit të pagesave.

Nëse pjesëmarrësi nuk e kthen plotësisht ose pjesërisht kredinë brenda ditës brenda afatit të caktuar, ai mund të paraqesë kërkesë për konvertimin e shumës së pakthyer nga kredia brenda ditës në kredi të disponueshme njëditore, për të cilën zbatohen dispozitat përkatëse të Vendimit për kredinë e disponueshme njëditore.

10. Nëse banka nuk e kthen kredinë brenda ditës dhe nuk paraqet kërkesë për konvertimin e kredisë brenda ditës në kredi të disponueshme njëditore, Banka Popullore e mbledh kredinë brenda ditës dhe të gjitha kërkesat e bazuara në kredi përmes ekzekutimit të instrumenteve të sigurisë.

11. Shlyerja e kredisë brenda ditës kryhet në bazë të elementeve të përcaktuara në konkluzion dhe në përputhje me rregulloret ligjore pozitive në këtë fushë.

12. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi për kredi brenda ditës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 42/11).

13. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga publikimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 02 - 40305/7
28 nëntor 2024
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
dr Anita Angellovska-Bezhoska